



TRANSPARENCA NË BASHKINË SHKODËR

Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës **“Intelektualet e rinj, Shpresa”**, në kuadër të projektit *“Bëhu aktiv, ndërto të ardhmen!”* me mbështetjen financiare të *Olof Palme International Center në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Suedeze*, nën drejtimin dhe udhëheqjen e njërës prej eksperteve më të mira në vendin tonë në fushën e të drejtës administrative, **Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku**, zëvendës Dekane e Fakultetit Juridik, pranë Universitetit Evropian të Tiranës. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e Olaf Palme International Center dhe Qeverisë Suedeze.

Shtypur: Shtypshkronja “Shkodra”, Shkodër - Albania

©Copyright: Intelektualet e rinj, Shprese
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Hyrje

Për një qeverisje të mirë dhe demokratike e drejta e informimit dhe transparencja përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët. Transparenca nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit, dhe si i tillë institucionet shtetërore duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij. Gatishmëria në dhënien e informacionit nga institucionet e administratës publike rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve.

Një nga mjetet më të rëndësishme në realizimin e kësaj të drejte është ekzistenca e një legjislacioni të mirë dhe zbatimi efektiv i tij në praktikë. Ndërkohë që situata duket më optimiste për sa lidhet me ekzistencën e kuadrit normativ që garanton këtë të drejtë, akoma edhe më shumë angazhim dhe vullnet nevojitet nga institucionet publike për zbatimin e tij në praktikë. Nga njëra anë kjo nënkupton garantimin e kësaj të drejte për qytetarët, pa u kushtëzuar në motivimin apo arsyetimin e qëllimit të kërkesës së tyre, dhe nga ana tjetër nënkupton parashikimin dhe zbatimin e sanksioneve në rastet e pajustificuara të mohimit të kësaj të drejte.

Raporti me titull “*Transparenca në Bashkinë Shkodër*”, u zbatua nga shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë”, në kuadër të Projektit “*Bëhu aktiv, ndërto të ardhmen*” është në vazhden e përpjekjeve të kësaj shoqate për të rritur kontributin e saj publik në forcimin e transparencës dhe të drejtës për informim si një e drejtë themelore e qytetarëve që duhet të respektohet dhe garantohet nga të gjitha institucionet. Në këtë kontekst, ky raport u fokusua në transparencën publike dhe respektimin e të drejtës së informimit nga ana e Bashkisë Shkodër, me qëllim nxjerrjen në pah të situatës aktuale të respektimit të ligjit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike vendore.

Miratimi i Ligjit Nr.149/2014 “*Për të drejtën e Informimit*” ishte një arritje e rëndësishme për të çuar përpara në një nivel akoma më të lartë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të individëve përkundrejt një administrate publike të hapur dhe në shërbim të tyre. Ky ligj përfshin në rrethin e organeve shtetërore për detyrim informimi edhe ato të qeverisjes vendore ashtu si edhe ligji i mëparshëm. Për këtë arsye, duke e vlerësuar këtë çështje me rëndësi për një qeverisje me baza demokratike, fluksin e qytetarëve për marrjen e shërbimeve në këto institucione, si dhe *problematikat që janë ngritur në mënyrë të vazhdueshme mbi garantimin e të drejtës së informimit dhe transparencës*, shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” është fokusuar në këtë raport për të monitoruar komunikimin e këtyre institucioneve me publikun, nivelin e aksesit në procedurat dhe dokumentacionin zyrtar dhe për të ndërgjegjësuar zyrtarët vendorë për respektimin e garancive kushtetuese dhe ligjore në lidhje me të drejtën për informim.

• Metodologjia

Në lidhje me realizimin e këtij studimi, metodologjia kryesore lidhet me analizën e legjislacionit mbi të drejtën e informimit dhe zbatimit të tij në praktikë, me theks tek autoritetet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, monitorimi i zbatimit të ligjit mbi programin e transparencës dhe detyrimet që lindin prej tij, me fokus Bashkinë Shkodër.

Po ashtu referime të caktuara janë bërë edhe në studime apo të dhëna të mëparshme të mbledhura për këtë qëllim nga shoqata ***“Intelektualët e rinj, Shpresë”*** në kuadër të projekteve dhe aktivitetit të saj që lidhet pikërisht me respektimin e detyrimeve të autoriteteve vendore në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, konkretisht të projektit ***“Bëhu aktiv, ndërto të ardhmen”***.

Kështu, për të realizuar këtë studim informacioni është grumbulluar nëpërmjet korrespondencës me Bashkinë Shkodër, vëzhgimeve në terren dhe gjatë aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Shkodër si dhe nëpërmjet monitorimit të website zyrtar të Bashkisë Shkodër <http://www.bashkiashkoder.gov.al>.

Gjithsej janë dërguar nga kjo shoqatë 9 kërkesa për informim ku është kërkuar informacion kryesisht në lidhje me zbatimin e ligjit Nr.119/2014 ***“Për të drejtën e informimit”*** si dhe të ligjit nr.146/2014, ***“Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”***. Nga këto kërkesa vetëm një prej tyre i është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 10 ditorë, dhe në 3 raste përgjigjet janë kthyer me ndërhyrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

I. Analizë e legjislacionit shqiptar mbi të drejtën e informimit

E drejta për informim është baza e përfshirjes së publikut në procesin e transparencës dhe të vendimarrjes e kontrollit të zbatimit të legjislacionit. Kjo e drejtë garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për të drejtën e informimit apo edhe ligje të tjera të posaçme.

a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 23 parashikon se e drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Po ashtu ky nen parashikon të drejtën e individit të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. Po ashtu neni 48 i Kushtetutës parashikon se kushdo, vetë ose me bashkë me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

b. Kodi i Procedurave Administrative

Neni 13 i Kodit të Procedurave Administrative, aktual, parashikon se Organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bashkëpunim të ngushtë me personat privatë duke u siguruar personave privatë informacionin dhe sqarimet e nevojshme. Po ashtu neni 20 me titull “*E drejta për t'u informuar*” parashikon se të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar. Organi administrativ, që zhvillon procedurën administrative, është i detyruar t'u japë informacion pjesëmarrësve në procedurë edhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

c. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ai përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike. Transparenca është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

d. Ligji, Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”

Mbi bazën e Kushtetutës, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rregullon në mënyrë të hollësishme të drejtën e informimit dhe realizimin e saj në praktikë, duke përcaktuar edhe detyrimet që burojnë nga ligji për organet publike në nivel qendror apo vendor, si dhe afatet e procedurat që duhet të respektohen në realizimin e kësaj të drejte. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Nga ana e tij, Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.

Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

- a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;*
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.*

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;*
- b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;*
- c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;*
- ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;*
- d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.*

Në qoftë se kërkesa për informim **nuk e përcakton formatin** në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

- **Afati**

Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, **por jo më vonë se 10 ditë pune** nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje **jo më vonë se 15 ditë pune** nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. Në çdo rast, mostrajtimi i **kërkesës për informim** brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet **refuzim**. *Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.*

- **Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës**

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) *garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
- b) *vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*
- c) *modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- a) *një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;*
- b) *tekstet e plota:*
 - i) *të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;*
 - ii) *të ligjeve;*
 - iii) *të akteve nënligjore;*
 - iv) *të kodeve të sjelljes;*
 - v) *të çdo dokumenti politikash;*

- vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;
- c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:
 - i) listën e kontratave të lidhura;
 - ii) shumën e kontraktuar;
 - iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
 - iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;*
- g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;*
- gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;*
- h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;*
- i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;*
- j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato;*
- k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;*
- l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.*

Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, konsiderohet kundravajtje administrative dhe dënohet me **50 000** deri në **100 000** lekë; po ashtu mosrishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me **50000** deri në **100 000** lekë;

Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik, vendor në këtë rast, cakton një prej nëpunësve si **koordinator për të drejtën e informimit.**

- **Ankimi administrativ**

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, **ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative** pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Neni 21 i Ligjit “**Për njoftimin dhe konsultimin publik**” ka parashikuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rast *se palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji.*

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditësh. Kur e sheh të përshtatshme Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.*

Komisioneri kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, *i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.*

- **Ankimi në gjykatë**

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionerit **në gjykatën administrative** kompetente.

Ligji Nr. 139/17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Neni 15 i ligjit përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatoren e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

- **Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore**

Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

- **Mbledhjet e këshillit të bashkisë**

Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

- **Seancat e këshillimeve me bashkësinë**

Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, dhe 77, shkronjat “a”, “dh”, “e”, “f” dhe “k”, të këtij ligji.

Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

- **E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes**

Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

- **E drejta e iniciativës qytetare**

Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.


II. Rezultatet e Monitorimit në Bashkinë Shkodër

2.1 Zbatimi i ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Bashkia Shkodër në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka miratuar dhe publikuar “Programin e Transparencës”, “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve” si dhe të tjerë modele dokumentesh, të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të këtij institucioni. Nga monitorimi rezulton se Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Bashkia Shkodër ka mundësi të ndërtojë dhe rrisë transparencën në veprimtarinë e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Bashkisë Shkodër, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare: www.bashkiashkoder.gov.al si dhe në mjediset e Zyrës me një Ndalesë. Programi i transparencës pasqyrohet në disa rubrika, tekste/përmbajtje, afatin kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument nuk është plotësisht i aksesueshëm edhe në skemë. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, si detyrime ligjore. Gjithashtu, është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit, siç rezulton nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë.

Më poshtë jepet një pamje e kësaj faqeje zyrtare për ilustrim.

Fig. 1 Faqja zyrtare e Bashkisë



Në mënyrë të vazhdueshme, shoqata **“Intelektualët e rinj, Shpresë”** ka bërë monitorimin e faqes zyrtare të Bashkisë për të evidentuar publikimin e Programit të Transparencës, caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe publikimin dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.119/2014 **“Për të drejtën e informimit”**, si dhe ka pasur kontakte të shpeshta me këtë institucion për efekt të realizimit të së drejtës për informim dhe referimit të rasteve/kërkesave të veçanta. Deri tani, rezulton se janë adresuar në këtë bashki 20 kërkesa për periudhën Janar-Shkurt 2016 dhe janë kthyer përgjigjet përkatëse nga kjo Bashki. Por nuk ka përditësime për kërkesa të tjera pas dates 23 Shkurt 2016.

Më konkretisht gjetjet janë dhënë si mëposhtë:

Në ligjin nr.119/2014 **“Për të drejtën e informimit”**, neni 4/1 i këtij ligji përcakton se:

“Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.”

Ajo që është vërejtur nga monitorimi lidhet me faktin se ndonëse ligji ka hyrë në fuqi më 2.11.2014, Programi i transparencës është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në datën 17 Mars 2016.


Në pikën 1 të nenit 7 të ligjit përcaktohet se: "autoritetet publike duhet të vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

Fig. 2 Faqja zyrtare e Bashkise, organograma e 2014

Në lidhje me percaktimet e gërmës c, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës, nga monitorimi i faqes zyrtare rezulton se ky informacion gjendet i përfshirë si pjesë e programit të transparencës si dhe në rubrikën “E drejta e informimit” ku është përcaktuar se “formati kërkesë” dhe “formati ankesë” gjendet në rubrikën “formular online”; por nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë nuk gjendet!

Fig 3. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Formular online”




Ajo që pasqyrohet tek rubrika “E drejta e informimit”, nënrubrika ‘Moduli i kërkesave’ lidhet me *Tipet e kërkesave me dokumentat përkatës*, ku pasqyrohet informacioni/dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet në lidhje me kërkesa si: leje apo licensa të ndryshme, certifikata, autorizime, etj.

Fig 4. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Moduli i kërkesave”




Në lidhje me percaktimet e mërzës ç, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion me të dhënat për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorsit për të drejtën e informimit, nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë është i paraqitur në mënyrë të plotë sipas përcaktimeve ligjore.

Fig 5. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Kordinatori për të Drejtën e Informimit të Bashkisë Shkodër”




Në lidhje me percaktimet e mërzës d, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion përsa i takon të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime; nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë nuk ekziston! Duke vëzhguar faqen e Bashkisë Shkodër rezulton madje që nuk ka informacion të tillë as për Kryetaren e Bashkisë Shkodër!

Fig 6. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Kryetari i Bashkisë”



Në lidhje me përcaktimet e gërmës dh, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit **rezultojnë se ekzistojnë të publikuara disa plane strategjike por mungojnë raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit si dhe dokumentet që përmbajnë treguesit e performancës së autoritetit!**

Fig 7. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Strategjitë planet”



Në lidhje me përcaktimet e gërmës e, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. Në lidhje me këtë pikë, informacioni i dhënë në lidhje me buxhetin është i plotë ndërsa informacioni në lidhje me tarifat e taksave dhe të licencave nuk është rifreskuar dhe i përket vitit 2014.

Fig 8. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Buxheti”





Fig 9. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Taksat dhe tarifat”




Në lidhje me percaktimet e gërmës ë, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

- i) listën e kontratave të lidhura;
- ii) shumën e kontraktuar;
- iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;
- iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

nga monitorimi në faqen zyrtare të Bashkisë një informacion i tillë nuk gjendet!

Fig 10. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Prokurimet Publike”



Në lidhje me përcaktimet e gërmës f, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, **në faqen zyrtare të Bashkisë gjendet informacion i mjaftueshëm i vlefshëm për publikun, si psh dokumentacioni që duhet të plotësojnë në lidhje me aplikime/kërkesa të ndryshme, gjë që konsiderohet mjaft pozitive!**

Fig 11. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Dokumenta për shkarkim”





Fig 12. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Moduli i kërkesave”



Në lidhje me përcaktimet e gërmës g, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi Informacion mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik,

Nga monitorimi nuk rezulton të jetë publikuar ndonjë mekanizëm apo procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik!

Në lidhje me përcaktimet e gërmës gj, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

Nga monitorimi nuk rezulton të jetë publikuar ndonjë mekanizëm apo procedurë përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë qeverisjen lokale!

Në lidhje me përcaktimet e gërmës h, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi sistemin që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; nga monitorimi rezulton se ky informacion është përfshirë në Programin e Transparencës

Në lidhje me përcaktimet e gërmës h, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji; nga monitorimi rezulton se rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve tashmë është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër

Fig 13. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve”

The screenshot shows the official website of the Municipality of Shkodër. The header includes the municipality logo and navigation links. The main content area is titled 'Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve' (Registry of Requests and Responses). It features a table with the following columns: Nr. regjistrimit të kërkesës, Objekti, Data e kthimit të përgjigjes, Statusi i kërkesës, and Tarifa. The table contains two entries. The first entry, numbered 01, is dated 08.01.2016 and relates to information on the right of access to information. The second entry, numbered 02, is dated 09.01.2016 and relates to information on the right of access to information. A sidebar on the left contains links to the transparency program and the registry. A calendar widget on the right shows the month of April 2016.

Nr. regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
01	Informacion për ligje ndërtimi (Kërkesë informacion në lidhje me një ndërtesë që duhet të bëjë në pronën që disponoj. Shërbimi është e arsyeshur dhe është e domosdoshme që të shpërbëhet dhe të bëhet një ndërtesë tjetër.)	27.01.2016 Ligji i ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese. Zona në të cilën ndodhet pronësia, rezulton të jetë zonë A2, zonë rezidenciale me shërbime të mëdha.	Përfunduar	Nuk ka
02	Informacion mbi punimet që do të kryejë, duhet të pajtohet me deklaratim paraprak.	27.01.2016 Punimet që kërkon të bëjë nuk e kanë të nevojshme pajtjen.	Përfunduar	Nuk ka

Në lidhje me përcaktimet e gërmës j, pika 1 të nenit 7 të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato; nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare është përfshirë informacioni në lidhje me format e ndihmës shoqërore si dhe procedurave për të përfituar!

Fig 14 Faqja Zyrtare e Bashkisë “Shërbimi i Ndihmës Ekonomike”



Fig 15. Faqja Zyrtare e Bashkisë “Taksat Tarifat Gjobot”



2.2 Zbatimi i ligjit nr.146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet detyrimi që kanë autoritetet publike për njoftimin dhe konsultimin publik. Sipas këtij neni organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, për këtë qëllim ato duhet që të përfshijnë:

- a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;
- c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Nga komunikimet zyrtare me Bashkinë Shkodër rezulton se nuk ekzistojnë plane vjetore të Bashkisë Shkodër që lidhen me procesin e vendimmarrjes. Po ashtu rregjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike të projektakteve ku mund të konsultohen të dhënat dhe projektaktet si nje mundësi komunikimi për të gjitha palët e interesuara te nderveprojnë me organin publik nuk parashikon mënyrën sesi keto palë mund të komunikojnë apo të dërgojnë komentet dhe rekomandimet e tyre. Mëposhtë jepet një model i saktë i njoftimit për konsultimin publik të projektakteve:

Fig 16. “Model njoftimi” marrë nga Faqja Zyrtare e Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile



Në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji përcaktohet se:

“Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrinelektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar.”

Nga komunikimet zyrtare me Bashkinë Shkodër rezulton se nuk ekziston një procesverbal për këto takime i mbajtur në formatin e kërkuar ligjor por thjesht disa materiale përshkruese të cilat nuk përmbajnë elementet e domosdoshëm të një dokumenti zyrtar.

Në nenin 10, të këtij ligji përcaktohet se:

“Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.”

Nga monitorimi i zhvilluar gjatë kësaj periudhe nuk rezulton se ka një person i cili kryen këtë funksion.

Në nenin 12, të këtij ligji përcaktohet se: *“Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.”* **Nga informacionet e marra nuk rezulton se një praktikë e tillë është zhvilluar nga Bashkia Shkodër.**

Sipas nenit 13 te ketij ligji percaktohet se:

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:
 - a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
 - b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
 - c) adresa e kontaktit të koordinаторit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
 - ç) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

Nga informacionet e grumbulluara rezultojnë se respektimi i këtij neni paraqet mangësi nga ana e Bashkisë Shkodër dhe sidomos në zbatimin e germës b) dhe c) ku në asnjërin prej njoftimeve nuk rezultojnë se është parashikuar afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara mund të paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre. Po ashtu siç u theksua edhe më lart nuk rezultojnë të tregohet adresa e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të Bashkisë Shkodër!

Fig 17. Faqja Zyrtare e Bashkise, konsulto online, “Projekte te aplikuar ne Qeverine Shqiptare”




Në nenin 15 të këtij ligji janë përcaktuar afatet për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve ku afati minimal është 20 ditë pune ndërsa për rastin e akteve komplekse ose të rëndësishme ky afat mund të jetë deri në 40 ditë pune.

Po ashtu në pikën 2 të Nenit 17 të këtij ligji përcaktohet se: “Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.”

Rezulton se Bashkia Shkodër në rastin e diskutimeve mbi projekt-buxhetin nuk e ka respektuar këtë afat ligjor ndërsa në rastin e diskutimeve mbi Planin Vendor ky afat është respektuar pjesërisht!

Fig 18. Ftesa e Bashkisë Shkodër, datë 25 Mars për konsultim e projekt buxhetit në datë 30 Mars 2016



Në pikën 19/3 të këtij ligji është përcaktuar se:

“Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.”

Nga informacionet e grumbulluara nëpërmjet korrespondencave me Bashkinë Shkodër nuk rezulton zbatimi i një praktike të tillë si dhe mungon procesverbali në formën e kërkuar zyrtare!

Në nenin 20 të këtij ligji është përcaktuar se organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

Nga informacionet e grumbulluara nuk rezulton që të jetë hartuar ose publikuar ndonjë raport vjetor mbi transparencën në procesin e vendimmarrjes.

III. Përfundime dhe rekomandime

Nga monitorimi i detyrimeve që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në lidhje me të drejtën e informimit dhe transparencën e institucioneve vendore, rezulton se në Bashkinë Shkodër janë bërë hapa pozitivë dhe ato reflektohen në vazhdimësi për efekt të respektimit të tyre, çka tregon për angazhim dhe përgjegjshmëri të këtyre zyrtarëve vendorë. Pavarësisht përmirësimeve në këtë drejtim, duhet theksuar se ende ka vend për të përmirësuar në respektimin e detyrimeve që u vendosen autoriteteve vendore për garantimin e së drejtës për informim.

Në korrespondencën e fundit të realizuar për këtë qëllim, është vënë theksi tek detyrimi i punonjësve të Bashkisë Shkodër për të dhënë përgjigje duke respektuar afatet ligjore të vendosura. Madje, shoqata i është drejtuar edhe Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), i cili pas shqyrtimit të rastit në fjalë e ka gjetur të drejtë ankimin tonë dhe i ka kërkuar Bashkisë Shkodër që të veprojë sipas ligjit, për efekt të dhënies së informacionit të kërkuar brenda datës 18.03.2016 (shkresa nr.343/1, dt.10.03.2016 e KDIMDP).

Nga analizimi i rasteve të paraqitura dhe monitorimit, evidentohen disa probleme në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe transparencën, siç u përmendën në mënyre më të detajuar mësipër. Për të përmirësuar situatën, rekomandimet e dala nga ky raport do të përmbledhen si mëposhtë:

- ***Kërkohet një njohje dhe zbatim më i plotë dhe më i mirë i ligjit për të drejtën e informimit, në mënyrë që qytetarët të marrin informacion të mjaftueshëm mbi të drejtën për informim dhe afatet ligjore për të marrë përgjigje për kërkesat apo ankesat e tyre;***
- ***Duhet bërë përditësim më i mirë i informacionit në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër në të gjitha rubrikat e saj, në mënyrë që qytetarët dhe çdo subjekt i interesuar të marrin informacionin më të fundit.***
- ***Po ashtu jo të gjithë janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe të aksesimit të informacionit që ajo përmban, apo edhe dinë ta përdorin; Qytetarët preferojnë të drejtohen direkt pranë zyrave të institucioneve vendore, pasi hasin vështirësi dhe pengesa burokratike për hartimin e kërkesave për informacion ose e kanë më të thjeshtë për të marrë informacion te drejtëpërdrejtë prandaj është e rëndësishme shtimi i sporteleve të informacionit dhe shërbimit në pika të ndryshme të territorit të Bashkisë Shkodër.***
- ***Duhet të respektohen procedurat dhe afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve dhe adresimin e kërkesave/ankesave, pasi shpesh nuk ka bashkërendim të punës mes strukturave të brendshme dhe vihet re mangësi në njohjen dhe në zbatimin e ligjit, duke ndikuar kjo në informacionin që jepet dhe afatet ligjore për kthimin e përgjigjeve.***
- ***Duhet të përditësohet informacioni që lidhet me taksat dhe tarifat vendore.***
- ***Duhet të hartohen plane vjetore të Bashkisë Shkodër që lidhen me procesin e vendimarrjes dhe të jepet informacioni i duhur për to.***
- ***Po ashtu duhet të krijohet rregjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike të***

projektakteve ku mund të konsultohen të dhënat dhe projektaktet dhe të ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik në mënyrë që palët e interesuara mund të komunikojnë apo të dërgojnë komentet dhe rekomandimet e tyre, si dhe të njihen me ato komente/rekomandime që janë pranuar ose jo.

- Duhet të bëhet e njohur çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, si dhe për çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik.*
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve mbi dispozitat ligjore që u garantojnë marrjen e informacionit edhe procedurat që duhet të ndjekin për realizimin e kësaj të drejte;*
- Informimi i vazhdueshëm i punonjësve të administrates dhe monitorimi i sjelljes së tyre, për sa lidhet me ndjekjen e procedurave dhe respektimin e afateve ligjore për dhënien e informacionit;*
- Propozimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore në mënyrë që të mos ketë paqartësi apo mbivendosje mes ligjit për të drejtën e informimit dhe atij për njoftimin dhe konsultimin publik.*
- Nxitja e profesionalizmit për të përmirësuar cilësinë dhe formën e dhënies së informacionit për qytetarët;*
- Forcimi i kapaciteteve të administratës për të përmbushur më së miri detyrimet me të cilat i ngarkon ligji për të drejtën e informimit;*
- Përmirësimi i punës nga punonjësit e administrates që t'u japin qytetarëve informacion dhe ndihmë se si dhe ku mund të parashtrihen kërkesat e tyre, kur këto janë në kompetencë të një organi tjetër;*
- Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare në lidhje me informacionin e dhënë dhe programin e transparencës nga ana e Bashkisë, si pjesë e detyrimit ligjor që ka.*
- Orientim më i mirë i qytetarëve në lidhje me adresimin e kërkesave dhe ankesave tek autoritetet kompetente përkatëse;*
- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të periodike në lidhje me kuptimin më të qartë të detyrimeve ligjore dhe zbatimin e tyre nga punonjësit e Bashkisë;*
- Bashkëpunim dhe bashkërendim më i mirë në dhënien e informacionit dhe trajtimin e kërkesave/ankesave;*
- Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe projekte apo aktivitete të përbashkëta duke nxitur mekanizmat monitorues të transparencës;*
- Rritja e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve për të drejtat dhe detyrimet ligjore në garantimin e të drejtës për informim dhe forcimin e transparencës institucionale.*
- Duhet të inkurajohet krijimi i komisioneve, bordeve, forumeve qytetare nga grupe të ndryshme të interesit ku të bëhet konsultimi i vendimarrjeve të Bashkisë në funksion të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve*
- Duhet të krijohen forma të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetareve online nëpërmjet blog/diskutime online apo zhvillimin e aplikacioneve mobile.*

Shenim: Ky raport pas prezantimit te tij me daten 18 Prill 2016 i eshte derguar Bashkise Shkoder per te dhene komentet e tyre ne lidhje me gjetjet e raportit duke i lene si afat perfundimtare per dergimin e komenteve daten 9 Maj 2016. Nga ana e Bashkise Shkoder nuk ka patur asnje pergjigje dhe nuk eshte derguar asnje koment cka tregon se gjetjet e raportit kane qene me vend dhe jane pranuar te gjitha nga Bashkia Shkoder!



"INTELEKTUALET E RINJ, SHPRESE" (I.R.SH)
"YOUNG INTELLECTUALS, HOPE" ("YIH")
L:"QEMAL STAFI", RR:"DAUT BORIÇI", NR= 874,
SHKODER, ALBANIA
TEL/FAX: +355 222 48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com
Date 18 Prill 2016

Drejtuar: **Znj.Voltana Ademi,**
Kryetare e Bashkise Shkoder

E nderuar znj.Kryetare,

Ju lutem gjeni bashkangjitur kopjen e Raportit te Pare mbi Transparencen ne Bashkine e Shkodres. Ne do te kerkonin vleresimin dhe komentet Tuaja si perfaqesuese e Bashkise Shkoder ne lidhje me gjetjet e Raportit duke na informuar ne menyre konkrete per ato gjetje te cilat jeni dakort dhe per ato gjetje te cilat nuk qendrojne duke na dhene edhe kopje te dokumentave ne menyre qe ti bashkangjesim per tu publikuar ne raportin final.

Ne do t'ju luteshim qe komentet Tuaja ti sillni brenda 20 diteve nga marrja e ketij njoftimi ose jo me vone se data 9 Maj 2016.

Nderkohe Ju rikujtojme edhe njehere se organizata e jone mbetet e perkushtuar per bashkpunimin me Bashkine Shkoder duke Ju ofruar te gjitha asistencen e nevojshme per te vazhduar kete iniciative e cila qe ne fillimet e saj ka dhene rezultatet e para pozitive!



Singerisht


Saimir Beqiraga

President i IRSH